

**Draft 24.09.2015**

**Projektligj**

**Nr. \_\_\_/2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998 "KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 83 pika 1 dhe 177 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**PJESA E PARË**

**PARIME THEMELORE**

**Neni 1**

**Në preambulën e Kushtetutës, pas fjalëve “me bindjen e thellë se” shtohen fjalët “vlerat evropiane”. Preambula e Kushtetutës ndryshon si vijon:**

*Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se vlerat evropiane, drejtësia, paqja, harmonia, dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, Vendosim këtë Kushtetutë:*

**Neni 2**

**Në nenin 2, pas paragrafit të tretë, shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje:**

4. Republika e Shqipërisë merr pjesë në Bashkimin Evropian për të ushtruar bashkërisht me shtetet e tjera pjesëtare kompetencat shtetërore, në bazë të një marrëveshje të ratifikuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

### **Neni 3**

**Në nenin 12, pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen që vijon:**

4. Forcat ushtarake të shteteve aleate mund të vendosen dhe të kalojnë në territorin shqiptar, si dhe forcat ushtarake shqiptare mund të dërgohen jashtë vendit, me vendim të Këshillit të Ministrave sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara.

### **Neni 4**

**Në nenin 18, pika 2, pas fjalëve “fetare a filozofike”, shtohen fjalët “orientimit seksual”.  
Neni 18, pika 2 ndryshon si vijon:**

Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, *orientimi seksual*, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

### **Neni 5**

**Neni 39, pika 2, ndryshon si vijon:**

Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, vetëm me vendim gjyqësor, si dhe kur parashikohet në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

### **Neni 6**

**Neni 43 ndryshon si vijon:**

Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse në rastet kur vendimi i gjykatës është i formës së prerë. Ligji mund të parashikojë ndryshe në rast të vlerës së pakët (vogël) të objektit të çështjes.

### **Neni 7**

**Në nenin 64 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:**

4. Shtetasit shqiptarë zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Parlamentin Evropian me votim të drejtpërdrejtë.

### **Neni 8**

**Pas nenit 80 shtohet neni 80/1 me këtë përmbajtje:**

80/1. Këshilli i Ministrave i raporton Kuvendit për vendimet që përgatit në kuadrin e pjesëmarrjes në institucionet e Bashkimit Evropian, mbi të cilat Kuvendi nxjerr konkluzione dhe harton rezoluta.

## **Neni 9**

**Në nenin 109, pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:**

3/1. Kjo e drejtë u njihet reciprokisht shtetasve të Bashkimit Evropian rezidentë në Shqipëri, sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

## **Neni 10**

**Neni 122 pika 3, shfuqizohet.**

## **Neni 11**

**Në nenin 122, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:**

2/1. E drejta e Bashkimit Evropian ka epërsi mbi të drejtën e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 12**

**Në nenin 131, pas paragrafit g, shtohet paragrafi 2 me këtë përmbajtje:**

Gjykata Kushtetuese nuk mund të shpallë antikushtetues një ligj të miratuar nga Kuvendi, për rishikimin e Kushtetutës.

## **Neni 13**

**Në nenin 161, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:**

2/1. Banka e Shqipërisë në zbatim të marrëveshjeve me Bashkimin Evropian u delegon institucioneve të këtij Bashkimi kompetenca nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

## **PJESA E TETË**

### **GJYKATA KUSHTETUESE**

## **Neni 14**

**Në nenin 124 shtohet paragrafi 3:**

### **Neni 124**

1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.
3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë që e administron në mënyrë të pavarur.

## **Neni 15**

**Neni 125 ndryshon si më poshtë vijon:**

### **Neni 125**

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, tre (3) prej të cilëve emërohen nga Presidenti, tre (3) anëtarë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre (3) anëtarë nga mbledhja e përbashkët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative. Anëtarët që emërohen nga Presidenti dhe Kuvendi përzgjidhen nga lista e hartuar nga Këshilli për Emërimet në Drejtësi. Procedura e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese parashikohet në ligj.
2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 12 vjet, pa të drejtë riemërimi dhe përzgjidhen nga rradhët e juristëve me të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë të së drejtës, nëpunës të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës. Kandidatët nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale, si dhe të mos jenë angazhuar në forumet drejtuese të partive politike. Kriteret e hollësishme për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese parashikohen në ligj.
3. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 4 vjet, në një të tretën e saj, sipas procedurës së caktuar me ligj.
4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën absolute të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për një periudhë 4 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje. Procedura e zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese parashikohet me ligj.
5. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.

## **Neni 16**

**Neni 126 ndryshon si më poshtë vijon:**

### **Neni 126**

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij.

## **Neni 17**

**Neni 127 ndryshohet si më poshtë vijon:**

### **Neni 127**

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:

- a) Mbush moshën 70 vjeç;
  - b) Përfundon mandati 12 vjeçar;
  - c) Jep dorëheqjen;
  - ç) Deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - d) Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose vendim përfundimtar në një procedurë disiplinore.
2. Mbarimi i mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.
  3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar gjyqtarin paraardhës, sipas nenit 125/1, emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.
  4. Në rast se mandati i gjyqtarit përfundon për shkaqet e parashikuara në nënparagrafët c); ç) dhe d) të paragrafit 1 të këtij neni, si dhe për shkelje disiplinore, sipas nenit 128, procedura e emërimit të anëtarit të ri fillon menjëherë dhe përfundon brenda 60 ditëve nga deklarimi i mbarimit të mandatit nga Gjykata Kushtetuese.

### **Neni 18**

**Neni 128 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 128**

Anëtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.

### **Neni 19**

**Pas nenit 128 shtohet neni 128/a, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 128/a**

Në rast se anëtari i Gjykatës Kushtetuese jep dorëheqjen, ia paraqet atë Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili njofton menjëherë organin e emërtesës për plotësimin e vendit vakant, sipas nenit 125.

### **Neni 20**

#### **Neni 129 (i pandryshuar)**

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.

### **Neni 21**

**Neni 130 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 130**

Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj..

## **Neni 22**

**Në nenin 131 ndryshohet shkronja f, si më poshtë vijon:**

f) Shqyrtimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër vendimeve gjyqësore dhe akteve të pushtetit publik që çenojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave përveç kur është parashikuar ndryshe në Kushtetutë.

## **Neni 23**

**Në nenin 131 shtohet shkronja g, me këtë përmbajtje:**

Gjykata Kushtetuese vendos për:

g) Shqyrtimin e mosmarrëveshjeve juridiksionale, si dhe të kompetencës lëndore dhe funksionale midis Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative, si dhe midis vetë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë Administrative.

## **Neni 24**

**Neni 132 ndryshohet si më poshtë vijon:**

### **Neni 132**

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.
2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si rregull, hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare, përveç kur është parashikuar ndryshe në ligj. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër. Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin.

## **Neni 25**

**Neni 133 (i pandryshuar)**

1. Pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj.
2. Gjykata Kushtetuese vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj.

## **Neni 26**

**Neni 134 ndryshohet si më poshtë vijon:**

### **Neni 134**

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:
  - a) Presidentit të Republikës;
  - b) Kryeministrit;
  - c) Jo më pak se një së pestës së deputetëve;
  - ç) Avokatit të Popullit;

- d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- dh) Çdo gjykatë sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;
- e) Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale;
- ë) Komisionerit kundër Diskriminimit;
- f) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- g) Organeve të qeverisjes vendore;
- gj) Organeve të bashkësive fetare;
- h) Partive politike dhe organizatave të tyre;
- i) Individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët ç, d, e, ë, f, g, gj, h dhe i të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre.

## **PJESA E NËNTË**

### **GJYKATAT**

#### **Neni 27**

**Neni 135 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 135**

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Lartë Administrative si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykimi administrativ organizohet në dy shkallë dhe përfshin Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Lartë Administrative.
3. Kuvendi krijon gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

#### **Neni 28**

**Neni 136 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 136**

1. Anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me mandat 12 vjeçar, pa të drejtë riemërimi.
2. Anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative zgjidhen nga rradhët e gjyqtarëve me të paktën 15 vjet përvojë, si dhe mes juristëve të spikatur me jo më pak se 20 vite përvojë që kanë punuar si avokatë, profesorë të së drejtës, ose në administratën e lartë publike. Ata duhet të mos jenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos kenë qenë të angazhuar në forumet drejtuese të partive politike. Kriteret dhe procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Gjykatës

së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative, si dhe kushtet për vazhdimësinë e ushtrimit të profesionit të gjyqtarit përcaktohen me ligj.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative zgjidhet për një periudhë 5 vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje, me votim të fshehtë dhe me shumicën absolute të anëtarëve. Procedura e zgjedhjes parashikohet në ligj.
4. Gjyqtarët e tjerë emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
5. Gjyqtarë mund të jenë vetëm shtetasit shqiptarë me arsim të lartë juridik. Kushtet dhe procedura e zgjedhjes caktohen me ligj.

## **Neni 29**

**Neni 137 ndryshohet si më poshtë vijon:**

### **Neni 137**

1. Gjyqtarët gëzojnë imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tyre.
2. Gjyqtarët mbajnë përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

## **Neni 30**

**Neni 138 ndryshohet si më poshtë vijon:**

### **Neni 138**

Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet, përveç rasteve kur parashikohet në Kushtetutë. Paga dhe përfitimet e tjera nuk mund të ulen, përveç rasteve kur ndaj gjyqtarëve jepet një sanksion.

## **Neni 31**

**Neni 139 ndryshohet si më poshtë vijon:**

1. Mandati si gjyqtar i Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative mbaron kur:
  - a) Mbush moshën 65 vjeç;
  - b) Përfundon mandati 12 vjeçar;
  - c) Jep dorëheqjen;
  - ç) Deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor te formës së prerë;
  - d) Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
2. Mbarimi i mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative deklarohet përkatësisht me vendim të Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative.
3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar gjyqtarin paraardhës, sipas nenit 136/1, emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.



4. Në rast se mandati i gjyqtarit përfundon për shkaqet e parashikuara në nënparagrafët c); ç) dhe d) të paragrafit 1 të këtij neni, si dhe për shkelje disiplinore, procedura e emërimit të anëtarit të ri fillon menjëherë dhe përfundon brenda 60 ditëve nga deklarimi i mbarimit të mandatit nga Gjykata e Lartë ose Gjykata e Lartë Administrative.

### **Neni 32**

**Pas nenit 139 shtohet neni 139/a, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 139/a**

Në rast se anëtari i Gjykatës së Lartë ose i Gjykatës së Lartë Administrative jep dorëheqjen, ia paraqet atë Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose Kryetarit të Gjykatës së Lartë Administrative, i cili menjëherë njofton organin e emërtesës që plotëson vakancën brenda 60 ditëve.

### **Neni 33**

#### **Neni 140 shfuqizohet**

### **Neni 34**

**Neni 141 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 141**

Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative kanë juridiksion rishikues dhe sigurojnë zbatimin uniform të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në juridiksionin e tyre hyjnë çështjet gjyqësore që shqyrtohen nga gjykatat më të ulëta, me përjashtim të çështjeve që i përkasin juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

### **Neni 35**

**Neni 142 (nuk ndryshon)**

1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.
2. Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative duhet t'i botojnë vendimet e tyre, si dhe mendimet e pakicës.
3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

### **Neni 36**

**Neni 143 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 143**

Qënia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.

### **Neni 37**

**Neni 144 shfuqizohet (përfshihet te neni 147)**

### **Neni 38**

**Neni 145 (nuk ndryshon)**

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.
2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.
3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjyqtarëve sjell përgjegjësi sipas ligjit.

### **Neni 39**

**Neni 146 (nuk ndryshon)**

1. Gjykatat i japin vendimet në emër të Republikës.
2. Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast.

### **Neni 40**

**Neni 147 ndryshohet si më poshtë vijon:**

**Neni 147**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor garanton pavarësinë, përgjegjshmërinë, si dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë. Gjashtë prej anëtarëve janë gjyqtarë të zgjedhur nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor. Kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë rregullohet me ligj. Pesë anëtarët e tjerë vijnë nga avokatia, 1 anëtar, trupa e pedagogëve të drejtësisë, 2 anëtarë, trupa e pedagogëve jo magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, 1 anëtar, dhe shoqëria civile, 1 anëtar. Anëtarët jo gjyqtarë emërohen nga Kuvendi me tri të pestat e gjithë anëtarëve mbi bazën e propozimeve nga strukturat përkatëse dhe të opinionit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
3. Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Kur në votimin e parë Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestash, struktura propozuese bën një propozim të ri brenda 15 ditëve. Këshilli i Emërimeve jep një opinion brenda 7 ditëve nga dorëzimi i propozimeve të reja. Kuvendi voton për kandidaturat e reja brenda 7 ditëve nga dorëzimi i opinionit të Këshillit të Emërimeve. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet kjo shumicë kandidatët e renditur më lart nga Këshilli i Emërimeve quhen të emëruar.
4. Ministri i Drejtësisë merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor si vëzhgues. Ministri i Drejtësisë mund të kërkojë fillimin e hetimit për shkelje disiplinore kundër gjyqtarëve.

5. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit anëtarët gjyqtarë rikthehen në vendet e mëparshme të punës. Anëtarët jo gjyqtarë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në pozicione të barazvlefshme me to.
6. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo gjyqtarë, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve. Kur në votimin e parë, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk e arrin shumicën prej dy të tretash, brenda 7 ditëve nga votimi i parë bëhet një votim i dytë. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet kjo shumicë, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet me shumicë të thjeshtë brenda 7 ditëve. Mandati i Kryetarit përkon me atë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

#### **Neni 41**

**Pas nenit 147 shtohet neni 147/a, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/a**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:
  - a) Emëron, vlerëson ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët, me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
  - b) Vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve, me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
  - c) I propozon Presidentit të Republikës kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative, sipas procedurës së caktuar me ligj;
  - d) Miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
  - e) Drejton dhe menaxhon administratën e gjykatave;
  - f) Propozon dhe administron buxhetin e gjykatave.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor bën planifikimin strategjik për sistemin gjyqësor, raporton publikisht dhe përpara Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor, si dhe ushtron përgjegjësi të tjera të caktuara me ligj.

#### **Neni 42**

**Pas nenit 147/a shtohet neni 147/b, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/b**

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron kur:
  - a) arrin moshën e pensionit;
  - b) përfundon mandati 5 vjeçar;
  - c) jep dorëheqjen;
  - ç) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose vendim përfundimtar në një procedurë disiplinore;

- d) deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
  3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147 emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.
  4. Kur mandati i anëtarit përfundon për shkaqet e parashikuara në pikat c), ç) dhe e) të këtij neni si dhe për shkelje disiplinore sipas nenit 147/c, procedura e emërimit të anëtarit të ri fillon menjëherë dhe përfundon brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit që deklarohet mbarimin e mandatit të anëtarit paraardhës.
  5. Kur anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor jep dorëheqjen, ia paraqet atë Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor i cili menjëherë njofton organin e emërtesës, i cili plotëson vendin vakant, sipas nenit 147.

### **Neni 43**

**Pas nenit 147/b shtohet neni 147/c, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/c**

Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.

### **Neni 44**

**Pas nenit 147/c shtohet neni 147/ç, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/ç**

Qënia anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.

### **Neni 45**

**Pas nenit 147/ç shtohet neni 147/d, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/d**

1. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe ankesave kundër gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj tyre. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin e gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;
2. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga 5 anëtarë, 3 nga të cilët vijnë nga gjyqësori dhe 2 nga prokuroria. Ata emërohen nga Kuvendi me tri të pestat e gjithë

anëtarëve, midis kandidatëve të përzgjedhur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor përzgjedh dhe rendit gjashtë kandidatë nga radhët e gjyqtarëve ose ish gjyqtarëve me të paktën 20 vjet përvojë si gjyqtarë, me rezultate të larta në punë dhe integritet të lartë, mbi bazën e propozimeve të gjyqtarëve. Procedura e përzgjedhjes dhe renditjes së kandidatëve rregullohet me ligj.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përzgjedh dhe rendit katër kandidatë nga radhët e prokurorëve ose ish prokurorëve me të paktën 20 vjet përvojë si prokurorë, me rezultate të larta në punë dhe integritet të lartë, mbi bazën e propozimeve të prokurorëve. Procedura e përzgjedhjes dhe renditjes së kandidatëve rregullohet me ligj.
5. Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestash për asnjë prej kandidatëve të secilit grup, kandidatët e renditur në 3 vendet e para nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe 2 vendet e para nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë quhen të emëruar.
6. Anëtarët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë kanë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.
7. Kandidatët për anëtar të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë i nënshtrohen një kontrolli të thelluar të pasurisë, të integritetit dhe të së shkuarës.
8. Procedurat për marrjen e vendimeve nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë rregullohen me ligj.
9. Ministri i Drejtësisë merr pjesë si vëzhgues në mbledhjet e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe mund të kërkojë fillimin e hetimit për shkelje disiplinore kundër gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm si dhe kryerjen e inspektimeve dhe verifikimin e ankesave.
10. Anëtarët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej nëntë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit anëtarët rikthehen në vendet e mëparshme të punës.
11. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë zgjidhet nga radhët e anëtarëve gjyqtarë me 2/3 e votave të anëtarëve të Inspektoratit. Kur në votimin e parë nuk arrihet shumica prej dy të tretash, brenda 7 ditëve nga votimi i parë bëhet një votim i dytë vetëm për kandidatin që ka marrë më shumë vota në votimin e parë. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet kjo shumicë, Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë brenda 7 ditëve.
12. Inspektori i Përgjithshëm drejton mbledhjet e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë si dhe bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës.

## **Neni 46**

**Pas nenit 147/d shtohet neni 147/dh, me këtë përmbajtje:**

**Neni 147/dh**

1. Mandati i anëtarit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë mbaron kur:
  - a) arrin moshën e pensionit;
  - b) përfundon mandati 9 vjeçar;
  - c) jep dorëheqjen;
  - ç) deklarohet nga gjykata i paaftë për të përmbushur funksionin e tij.
  - d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose vendim përfundimtar në një procedurë disiplinore.
2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Kur anëtari i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë jep dorëheqjen, ia paraqet atë Inspektorit të Përgjithshëm, i cili menjëherë njofton organin e emërtesës për plotësimin e vendit vakant, sipas nenit 147/d, pika 2/3/4.
3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147/d, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.
4. Kur mandati i anëtarit përfundon për shkaqet e parashikuara në pikat c), ç) dhe d) të këtij neni si dhe për shkelje disiplinore sipas nenit 147/e, procedura e emërimit të anëtarit të ri fillon menjëherë dhe përfundon brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit që deklaroi mbarimin e mandatit të anëtarit paraardhës.

#### **Neni 47**

**Pas nenit 147/e shtohet neni 147/dh, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/e**

Anëtari i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Inspektimi në këtë rast kryhet nga Ministri i Drejtësisë.

#### **Neni 48**

**Pas nenit 147/e shtohet neni 147/ë, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/ë**

Qënia anëtar i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.

#### **Neni 49**

**Pas nenit 147/ë shtohet neni 147/f, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 147/f**

1. Tribunali Disiplinor i Drejtësisë shqyrton rastet e shkeljeve disiplinore dhe vendos masa disiplinore për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm, anëtarët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe punonjësve të këtij Komisioni si dhe shqyrton ankimet kundër masave disiplinore të vendosura ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
2. Tribunali Disiplinor përbëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, anëtari më i vjetër i Gjykatës Kushtetuese, anëtari më i vjetër i Gjykatës së Lartë dhe anëtari më i vjetër i Gjykatës së Lartë Administrative.
3. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese është Kryetar i Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë. Kryetari i Gjykatës së Lartë është Zëvendës Kryetar i Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë.
4. Organizimi dhe funksionimi i Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë rregullohet me ligj.
5. Ankimet kundër vendimeve të Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

## **PJESA E DHJETË**

### **PROKURORIA**

#### **Neni 50**

**Neni 148 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 148**

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.
2. Prokuroria është një organ i pavarur dhe funksionon mbi parimin e decentralizimit, sipas ligjit.
3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre, prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.
4. Prokurorët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me propozim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pas mbarimit të Shkollës së Lartë të Magjistraturës, si dhe pas një vlerësimi dhe kontrolli pozitiv të pasurisë dhe të së shkuarës së tyre.
5. Prokurorët kanë përgjegjësi disiplinore në përputhje me ligjin.

#### **Neni 51**

**Pas nenit 148 shtohet neni 148/a, me këtë përmbajtje:**

## **Neni 148/a**

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për çështje të statusit dhe karrierës së prokurorëve. Elementët e statusit, mënyra e vlerësimit dhe ecuria profesionale e prokurorëve rregullohen me ligj.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë. Gjashtë prej tyre janë prokurorë të zgjedhur nga prokurorët e të gjitha shkallëve të prokurorisë. Kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve prokurorë rregullohet me ligj. Pesë anëtarët e tjerë vijnë nga avokatia, 1 anëtar, trupa e pedagogëve të drejtësisë, 2 anëtarë, trupa e pedagogëve jo magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, 1 anëtar dhe shoqëria civile, 1 anëtar. Anëtarët jo prokurorë emërohen nga Kuvendi më tri të pestat e të gjithë anëtarëve, në bazë të propozimeve nga strukturat përkatëse dhe të opinionit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
3. Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Në rast se në votimin e parë Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestash, struktura propozuese bën një propozim të ri brenda 15 ditëve. Këshilli i Emërimeve jep një opinion të ri brenda 7 ditëve nga dorëzimi i propozimeve të reja. Kuvendi voton për kandidaturat e reja brenda 7 ditëve nga dorëzimi i opinionit të Këshillit të Emërimeve. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet kjo shumicë kandidati i renditur më lart nga Këshilli i Emërimeve quhet i emëruar.
4. Ministri i Drejtësisë merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Prokurorisë si vëzhgues. Ministri i Drejtësisë mund të kërkojë fillimin e hetimit për shkelje disiplinore kundër prokurorëve.
5. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë këtë detyrë me kohë të plotë për një periudhë prej 5 vjetësh pa të drejtë rizgjedhje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit anëtarët prokurorë rikthehen në vendet e mëparshme të punës. Anëtarët jo prokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në pozicione të barazvlefshme me to.
6. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo prokurorë me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve. Kur në votimin e parë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk e arrin shumicën prej dy të tretash, brenda 7 ditëve nga votimi i parë bëhet një votim i dytë. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet kjo shumicë, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet me shumicë të thjeshtë brenda 7 ditëve.

## **Neni 52**

**Pas nenit 148/a shtohet neni 148/b, me këtë përmbajtje:**

## **Neni 148/b**



1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:
  - a) Emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët;
  - b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve;
  - c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj.
  - d) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë harton plane strategjike për Prokurorinë, raporton publikisht dhe përpara Kuvendit mbi gjendjen e Prokurorisë dhe ushtron përgjegjësi të tjera të caktuara me ligj.

### **Neni 53**

**Pas nenit 148/b shtohet neni 148/c, me këtë përmbajtje:**

#### **Neni 148/c**

1. Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion e Prokurorisë është përgjegjëse për ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës kundër gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të lartë, të përcaktuar me ligj, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Anti-Korrupsion.
2. Prokurorët e Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion janë të pavarur.
3. Prokurorët e Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion duhet të kenë 10 vite përvojë si prokurorë, nuk duhet të jenë të dënuar, duhet të kenë reputacion për integritet të lartë, si dhe duhet të plotësojnë një deklaratë e të kalojnë me sukses një shqyrtim të pasurisë dhe së shkuarës, si dhe shqyrtime periodike të llogarive financiare dhe telekomunikimeve të tyre si dhe të familjarëve të afërt.
4. Prokurorët e Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion emërohen për një mandat 10-vjeçar nga Këshilli i Lartë i Prokurorëve.
5. Byroja Kombëtare e Hetimit kryen hetime nën drejtimin e prokurorëve të Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion e Prokurorisë.

### **Neni 54**

**Neni 149 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 149**

1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga 3/5 e deputetëve, me propozim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe mbi opinionin e Këshillit për Emërimet në Drejtësi për një periudhë 9 vjeçare, pa të drejtë ri-emërimi. Procedura për përzgjedhjen dhe emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm përcaktohet me ligj.
2. Prokurori i Përgjithshëm përzgjidhet mes juristëve me kualifikime të larta, me përvojë jo më pak se 15 vite në profesion, me moral dhe integritet të lartë profesional, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, ose që kanë kryer sëpaku studime pasuniversitare të nivelit të parë në një universitet të shquar brenda ose jashtë Shqipërisë. Ai nuk duhet të jetë dënuar më parë për kryerjen një vepër penale, dhe nuk duhet të ketë mbajtur një post

politik apo një post në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit për postin e Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Prokurori i Përgjithshëm mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.
4. Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:
  - a) Përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese;
  - b) Lëshon vetëm udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e Prokurorisë, me përjashtim të atyre të Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion;
  - c) Përfaqëson Prokurorinë përpara shteteve të huaja, me përjashtim të Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion;
  - ç) Menaxhon administrimin e Prokurorisë, me përjashtim të Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion;
  - d) Propozon dhe administron buxhetin e Prokurorisë;
  - dh) Bën planifikimin strategjik për Prokurorinë, raporton në mënyrë publike dhe përpara Parlamentit mbi gjendjen e Prokurorisë si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj.

## **Neni 55**

**Pas nenit 149 shtohet neni 149/a, me këtë përmbajtje:**

### **Neni 149/a**

1. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron kur:
  - a) Mbush moshën 70 vjeç;
  - b) Jep dorëheqjen;
  - c) Deklarohet i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - ç) Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepër penale ose vendim përfundimtar në një procedurë disiplinore.
2. Përfundimi i mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë ose pas vendimit të Tribunalit Disiplinor që deklaron se Prokurori i Përgjithshëm ka kryer një shkelje të rëndë disiplinore.
3. Pas përfundimit të mandatit 9-vjeçar, Prokurori i Përgjithshëm emërohet si gjyqtar në gjykatën e apelit.

**Pas Pjesës së dhjetë shtohet Pjesa e dhjetë/1 me këtë përmbajtje:**

## **Neni 57**

### **Neni 149/1**

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është përgjegjës për të verifikuar përmbushjen e kushteve ligjore dhe të kriterëve profesionale e morale të kandidatëve jo gjyqtarë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidatëve jo prokurorë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të kandidatit për Prokuror të Përgjithshëm si dhe të

kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Në ushtrim të përgjegjësive të tij, Këshilli për Emërimet në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët e propozuar nga institucionet propozuese si dhe këshillon Kuvendin dhe Presidentin në bërjen e emërimeve.

2. Këshilli për Emërimet në Drejtësi mblidhet sa herë është e nevojshme.
3. Këshilli për Emërimet në Drejtësi përbëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, gjyqtari më i vjetër i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari më i vjetër i Gjykatës së Lartë dhe gjyqtari më i vjetër i Gjykatës së Lartë Administrative.
4. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është Kryetar i Këshillit për Emërimet në Drejtësi. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është Zëvendës Kryetar i Këshillit për Emërimet në Drejtësi.
5. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëpërmjet administratës së Këshillit, krijon kushtet e punës për veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve, si dhe për dokumentimin e kësaj veprimtarie.
6. Mënyra e funksionimit të Këshillit për Emërimet rregullohet me ligj.

## **PJESA E TËTËMBËDHJETË**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

#### **Neni 57**

**Neni 179 ndryshohet si më poshtë vijon:**

#### **Neni 179**

1. Mandati i organeve kushtetuese që do të ekzistojnë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbaron sipas dispozitave të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre, si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, sipas mandatit të mëparshëm. Përtëritja e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese do të bëhet si më poshtë:
  - a) Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët që u mbaron mandati në vitin 2016 do të emërohen përkatësisht nga Presidenti dhe nga Kuvendi dhe do të qëndrojnë në detyrë deri në vitin 2026.
  - b) Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilët i mbaron mandati në vitin 2017 do të emërohen nga mbledhja e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative dhe do të qëndrojnë në detyrë deri në vitin 2026.
  - c) Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët që u mbaron mandati në vitin 2019 do të emërohen përkatësisht nga Presidenti, nga Kuvendi dhe nga mbledhja e

Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative dhe do të qëndrojnë në detyrë deri në vitin 2030.

- c) Anëtari i ri që do të zëvendësojë anëtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020 do të emërohet nga Presidenti dhe do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2030.
- d) Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët të cilëve u mbaron mandati në vitin 2022 do të emërohen përkatësisht nga Kuvendi dhe nga mbledhja e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative, si dhe do të qëndrojnë në detyrë deri në vitin 2034.

- 3. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë veprimtarinë e tyre, si anëtarë të Gjykatës së Lartë, sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati do të emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.
- 4. Anëtarët e Gjykatës së Lartë Administrative do të emërohen brenda 3 muajve nga konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas këtij ligji. Emërimet e para në Gjykatën e Lartë Administrative përshkallëzohen në mënyrë në të sigurohet vazhdimësia në punën e kësaj gjykate.
- 5. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë veprimtarinë e tyre, si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor bëhet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe 2 jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor do të emërohen fillimisht për një mandat 3 vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi.
- 6. Prokurori i Përgjithshëm qëndron në detyrë deri në emërimin e Prokurorit të ri të Përgjithshëm, sipas këtij ligji. Prokurori i Përgjithshëm në detyrë emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit të Tiranës brenda 3 muajve nga data e mbarimit të mandatit.
- 7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë prokurorë dhe 2 jo prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të emërohen fillimisht për një mandat 3 vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi.

## **Neni 58**

### **Pas nenit 179 të Pjesës së shtatëmbëdhjetë shtohet neni 179/1 me këtë përmbajtje:**

Bazuar në dispozitat e Aneksit me titull ‘Vlerësimi Kalimtar i Kualifikimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve’, të gjithë gjyqtarët, përfshi anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, prokurorët, anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me përjashtim të rasteve kur këta të fundit zëvendësohen në pajtim me Nenin 179 nr. 5 të Kushtetutës, Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë me përjashtim të rasteve kur ky zëvendësohet në pajtim me Nenin 179 nr. 6 të Kushtetutës, si dhe këshilltarët ligjorë pranë tyre, do të vlerësohen dhe rivlerësohen *ex officio* në mënyrë që të rivendoset besimi i publikut dhe besimi tek këto institucione të rëndësishme demokratike.

## **Vlerësimi Kalimtar i Kualifikimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.**

### **Neni 1**

#### **Masat për të Fituar Besimin Publik**

1. Me qëllim që të garantohen në mënyrë të barabartë të drejtat e qytetarëve të Shqipërisë për t'iu drejtuar gjykatave për një gjykim të drejtë; me qëllim që të ndiqen veprat penale mbi bazën e një procesi të rregullt ligjor; por nisur edhe nga shqetësimet e bazuara se kjo e drejtë mohohet nga korrupsioni, ndikimet kriminale dhe puna e dobët e disa anëtarëve të gjyqësorit ose prokurorisë; zbatimi i disa neneve ekzistuese të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve 128, 131 f, 135, 138, 140, 145 /1, 147 /6, 149 /2, të variantit përpara hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, kufizohen deri në masën e nevojshme që lejon zbatimin e dispozitave të kësaj Pjese. Të gjithë gjyqtarët, përfshi anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, prokurorët, anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me përjashtim të rasteve kur këta të fundit zëvendësohen në pajtim me Nenin 179 nr. 5 të Kushtetutës, Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë me përjashtim të rasteve kur ky zëvendësohet në pajtim me Nenin 179 nr. 6 të Kushtetutës, si dhe këshilltarët ligjorë pranë tyre, vlerësohen dhe rivlerësohen *ex officio* në mënyrë që të rivendoset besimi i publikut dhe besimi tek këto institucione të rëndësishme demokratike. Rivlerësimi do të përfshijë të gjithë personat të listuar në fjalinë e dytë, pavarësisht transferimeve të përkohshme ose lejeve.
2. Krijohet Komisioni i Pavarur i Kualifikimit si dhe do të zhvillohet një Vlerësim për Kualifikimin.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vepron dhe vendos në mënyrë të pavarur, në pajtim me dispozitat e kësaj Pjese. Procedura e Presidentit për të përjashtuar kandidatë që nuk përmbushin kriteret, struktura, juridiksioni dhe procedurat e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbrojtja personale e anëtarëve të tij dhe afatet kohore të vlerësimeve, rregullohen me ligj të veçantë.

### **Neni 2**

#### **Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit**

1. Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit është një bashkëpunim ndërmjet Komisionit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, organizatave të tjera ndërkombëtare dhe asistencës ndërkombëtare dypalëshe. Ky Mision ka të drejtë të emërojë vëzhgues ndërkombëtarë në të dyja shkallët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ai kryesohet dhe vepron nëpërmjet Komisionit Evropian që koordinon ndihmën ndërkombëtare.
2. Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë kualifikime të ngjashme me komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Vëzhguesit Ndërkombëtarë kanë të drejtë të hulumtojnë në mënyrë të plotë çdo dosje vlerësimi në të gjitha nivelet e vlerësimit të kualifikimit; ata bëjnë konstatime ose japin opinione në çdo fazë të

- vlerësimit të kualifikimit si dhe, mund të paraqesin apo të kërkojnë prova në lidhje me të.
3. Vëzhguesit Ndërkombëtarë mund ta dërgojnë çështjen për shqyrtim në Komisionin e Pavarur Alternativ të shkallës së parë ose në Komisionin e Zgjeruar të Shkallës së Apelit, sidomos në rast se ata e konsiderojnë të paarsyeshëm vendimin e propozuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose nëse konstatojnë tregues të mjaftueshëm dhe bindës që vendimi i propozuar është i papërshtatshëm, nuk mban parasysh fakte ose prova të rëndësishme, nuk bazohet në ligj, ose është rezultat i një ndikimi të papërshtatshëm. Në qoftë se vëzhguesi ndërkombëtar e dërgon çështjen tek Komisioni i Pavarur Alternativ ose Komisioni i Zgjeruar i Shkallës së Apelit, atëherë ky i fundit vendos në vend të Komisionit të mëparshëm kompetent. Personi i vlerësuar mund të ankimojë vendimin e Vëzhguesve Ndërkombëtarë të Komisionit të Shkallës së Parë tek Vëzhguesi Ndërkombëtar i komisionit të ankimit brenda një jave.
  4. Në rast se Kuvendi zgjedh një Komision të Pavarur të Kualifikimit të shkallës së parë, Komisioni i Pavarur Alternativ i shkallës së parë do të përbëhet nga tre Komisionerë zëvendësues. Në rast se Kuvendi zgjedh dy Komisione të Pavarur të Kualifikimit të shkallës së parë, Komisioni i Pavarur Alternativ i shkallës së parë që do të marrë në shqyrtim çështjen, do të jetë Komisioni që nuk e ka marrë në shqyrtim atë çështje. Në rast se Kuvendi zgjedh tre Komisione të Pavarura të Kualifikimit të shkallës së parë, si Komisioni i Pavarur Alternativ i shkallës së parë do të shërbejë njëri nga Komisionet e shkallës së parë.

### **Neni 3 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**

1. Çdo Komision i Pavarur Kualifikimi përbëhet nga dy komisionerë publik, tre komisionerë të shkallës së parë nga secili prej tre Komisioneve të Shkallës së parë, dhe një Komision të Shkallës së Dytë të përbërë nga tre komisionerë të apelit dhe të paktën tre komisionerë zëvendësues. Në rast se zgjidhet vetëm një Komision i Shkallës së Parë, atëherë zgjidhen të paktën gjashtë komisionerë zëvendësues. Ata do të jenë në detyrë nga data 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2019. Komisionet humbasin fuqinë dhe pushojnë së vepruari menjëherë pas kësaj date, me përjashtim të rastit kur Kuvendi vendos me shumicë të thjeshtë zgjatjen e afatit të tyre.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vepron me përgjegjshmëri, integritet dhe transparencë, duke pasur si qëllim mbarëvajtjen e një sistemi drejtësie të pavarur, të aftë profesionalisht dhe të pakorruptuar.
3. Të gjithë komisionerët, drejtorët dhe personeli tjetër, sipas parashikimeve në ligj, japin pëlqimin për deklarin vjetor të pasurive të tyre, monitorimin e përhershëm të llogarive të tyre financiare dhe heqjen dorë nga konfidencialiteti i komunikimeve të tyre në lidhje me punën, për një periudhë kohore prej dhjetë vjetësh. Të gjitha deklaratat e pasurive të tyre bëhen publike.
4. Të gjithë Komisionerët duhet të jenë diplomuar në drejtësi, me gradën “master” ose me grada të niveleve më të larta, të përfuara në Shqipëri ose jashtë shtetit, dhe kanë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet eksperiencë si gjyqtar, prokuror, avokat, noter,

pedagog në drejtësi, jurist në ministri a në administratë publike, ose një profesion tjetër në lidhje me gjyqësorin, si dhe të gëzojnë reputacion të lartë integriteti. Kandidatët për komisionerë nuk mund të kenë qenë gjyqtarë, prokurorë ose këshilltarë ligjorë në periudhën dy vjeçare para emërimit të tyre. Kandidatët për komisionerë nuk mund të kenë qenë zyrtarë të zgjedhur, emëtime politike, apo zyrtarë të ndonjë partie politike në periudhën dhjetë vjeçare para emërimit të tyre. Kandidatët për komisionerë nuk mund të kenë qenë dënuar për ndonjë vepër penale që dënohet me burgim, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë.

5. Të gjithë kandidatët që aplikojnë për detyrën e komisionerit paraqesin një curriculum vitae, kopje të diplomave të tyre dhe pasaportës dhe një deklaratë të nënshkruar të plotë dhe të azhornuar të pasurive, në përputhje me Ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.
6. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e dispozitave të kësaj Pjese, institucioni i Avokatit të Popullit fton publikisht paraqitjen e aplikimeve për pozicionin e Komisionerëve brenda një afati një muajor nga momenti i ftesës publike. Të gjitha gjykatat shqiptare dhe institucionet shtetërore mund të propozojnë kandidatë dhe të shprehin pëlqimin e tyre për aplikimet e kandidatëve. Çdo qytetar shqiptar që përmbush kriteret e kërkuara nga këto dispozita dhe nga ligji mund të aplikojë për këtë pozicion. Institucioni i Avokatit të Popullit, brenda një muaji, pranon kërkesat dhe verifikon nëse përmbushen të gjitha kriteret dhe dërgon listën me aplikime në Kuvend. Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejtë të hulumtojnë në mënyrë të plotë çdo individ dhe dokumentacionin për të monitoruar procesin e aplikimit dhe të kualifikimit për komisionerët.
7. Brenda një muaji pasi është përcaktuar lista e kandidatëve, Kuvendi vendos me shumicë të thjeshtë nëse do të ngrihet një, dy apo tre Komisione të Shkallës së Parë; vendos me shumicë të thjeshtë për numrin e Komisionerëve zëvendësues; dhe emëron me shumicë 3/5 Komisionerët e Shkallës së Parë dhe të Shkallës së Apelit, si dhe dy Komisionerët Publik nga lista e kandidatëve të paraqitur nga Avokati i Popullit. Kuvendi gjithashtu zgjedh paktën tre komisionerë zëvendës me shumicë 3/5 bazuar në renditjen prioritarë të kryer për të lehtësuar përzgjedhjen. Nëse Kuvendi nuk arrin të zgjedhë të gjithë komisionerët me një shumicë 3/5 brenda një muaji, nga dita e paraqitjes së numrit dhe listës së kandidatëve, Presidenti i Republikës zgjedh publikisht komisionerët që mungojnë nga numri i kandidatëve që plotësojnë kriteret me short, brenda një muaji. Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejtë të hulumtojnë në mënyrë të plotë çdo individ dhe dokumentacionin për të monitoruar procesin e aplikimit dhe të kualifikimit për komisionerët.
8. Të gjithë komisionerët punojnë me kohë të plotë dhe nuk mund të ketë detyra ose punësime të tjera gjatë mandatit, në pajtim me Nenin 143 të Kushtetutës. Të gjithë Komisionerët kanë të njëjtin status me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, gjatë gjithë mandatit. Të gjithë komisionerët kanë pagë bruto prej 600 000 lekë në muaj. Komisionerët marrin pagën e tyre pavarësisht kohëzgjatjes aktive të mandatit për dhjetë vjet, përveç rasteve kur largohet para përfundimit të mandatit me vendim të Tribunalit Disiplinor. Ata marrin pension vjetor shtesë, për çdo vit të plotë shërbimi

- në masën 2% të pagës vjetore. Për periudhat më të shkurtra se një vit, pensioni llogaritet përkatësisht. Pensioni paguhet çdo muaj pas përfundimit të vitit të dhjetë.
9. Komisioneri Publik përfaqëson interesin publik përpara çdo shkalle të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ai kërkon dhe paraqet prova dhe mund të ankimojë vendimin e Komisionit të shkallës së parë.
  10. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka një Kancelar dhe të paktën tre Drejtorë, çdonjëri prej të cilëve mbikëqyr përkatësisht deklaratimet e pasurive, vlerësimet e performancës dhe vlerësimet paraprake. Drejtorët paraqesin raporte për vlerësimin e çdo personi dhe i rekomandojnë masën Komisionit. Detyrat e tjera të drejtorëve parashikohen me ligj.
  11. Buxheti, personeli dhe mjediset për të ushtruar detyrat e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të Vëzhguesve ndërkombëtarë parashikohen me ligj, në masë të mjaftueshme për të mbështetur veprimtarinë e tyre.
  12. Gjuha zyrtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë gjuha shqipe dhe angleze, dhe për këtë qëllim punësohen përkthyes.
  13. Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimeve i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore që vendoset nga tribunali disiplinor, i ngritur sipas Nenit 147/f.
  14. Komisionerët, vëzhguesit ndërkombëtarë, personeli i Komisionit dhe familjet e tyre, gëzojnë mbrojtje të nivelit më të lartë, në pajtim me ligjin.

#### **Neni 4 Vlerësimi i Kualifikimit**

1. Çdo person që vlerësohet sipas përcaktimeve në nenin 184, paragrafi 1, i nënshtrohet një Vlerësimi të Kualifikimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Personi i vlerësuar do t'i nënshtrohet një Vlerësimi të Pasurive sipas Nenit 188, një Vlerësimi Paraprak sipas Nenit 189 dhe një Vlerësimi Performance sipas Nenit 190. Kur personi i vlerësuar dorëhiqet nga detyra, vlerësimi i tij pushon menjëherë, pavarësisht nga koha e dorëheqjes, si përpara, ashtu edhe gjatë kohës së vlerësimit. Personat nën vlerësim që dorëhiqen nga detyra sipas kësaj dispozite, nuk mund të shërbejnë si gjyqtar të ndonjë shkallë gjykimi, si prokuror, si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ose Prokuror i Përgjithshëm, për një kohëzgjatje prej dhjetë vjetësh.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të publikojë informacion dhe të marrë parasysh komentet e marra nga publiku. Ai vepron në respektim të parimit të balancës ndërmjet jetës private dhe nevojave për hetim.
3. Organet zyrtare të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë dhe deklarojnë informacionin e kërkuar tek Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ofrojnë akses të drejtpërdrejtë në bazat e tyre të të dhënave për këtë komision, si dhe mund të ofrojnë opinione ose propozime në pajtim me ligjin.
4. Drejtorët e Komisionit, Komisioneri, Komisioneri Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtarë rishikojnë pyetësozin e verifikimit paraprak për personin e vlerësuar dhe deklaratat e paraqitura, mund të intervistojnë njerëzit e përmendur në pyetësor, ose të tjerë dhe bashkëpunojnë me institucionet e tjera shtetërore ose të huaja për të rishikuar vërtetësinë ose saktësinë e deklaratimit. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit



dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë tek të gjitha bazat e të dhënave përkatëse të qeverisë dhe tek dosjet, nëse nuk janë të klasifikuara. Ata kanë të drejtë të njihen me dosjet personale të personave të vlerësuar, të dhënat statistikore, dosjet e përzgjedhura për vlerësim, vetë-vlerësimet, opinionet e eprorëve, të dhënat për trajnimet dhe ankesat, verifikimet e ankesave, vendimet disiplinore ndaj personit të vlerësuar, regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, llogaritë bankare, zyrat tatimore, bazat e të dhënave për regjistrimin e pronësisë së makinave, dokumentimin e kontrollit kufitar, si dhe çdo dokument tjetër përkatës.

5. Regjistruesi përpilon një dosje me relacionet, rekomandimet dhe dosjet mbi vlerësimet për sendet pasurore, paraprake dhe të performancës, dhe ia paraqet atë Komisionit.
6. Komisioni i rishikon të treja dosjet e vlerësimit në pajtim me procedurat e parashikuara me ligj, dhe bazuar në një vlerësim të të tre raporteve dhe informacionit të përfutur, merr vendim.
7. Vëzhguesit Ndërkombëtarë kanë të drejtë të njohin dhe të ndjekin të gjitha fazat e Vlerësimit të Pasurive, Vlerësimit Paraprak dhe Vlerësimit të Performancës, si në shkallën e parë, edhe në shkallën e dytë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimeve.

#### **Neni 5 Vlerësimi i pasurive**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen një vlerësim të sendeve pasurore të punonjësve që i nënshtrohen rivlerësimit sipas Nenit 184, paragrafi 1, me qëllim identifikimin e personave të vlerësuar, të cilët zotërojnë ose kanë përdorur sende pasurore tej atyre që shpjegohen në mënyrë të ligjshme, ose atyre personave të vlerësuar që nuk kanë deklaruar në mënyrë të saktë e të plotë, sendet e tyre pasurore dhe ato të familjeve të tyre.
2. Personat e vlerësuar paraqesin përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një deklaratë të re të hollësishme, të azhurnuar për sendet e tyre pasurore, sipas Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003, për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesave, të ndryshuar.
3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, rishikon deklarin e pasurive dhe i paraqet Kancelarit të Komisionit një raport në lidhje me ligjshmërinë e pasurive dhe saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, si dhe mund të paraqesë një rekomandim në lidhje me masat disiplinore.
4. Të ardhurat e ligjshme përcaktohen me ligj të veçantë. Konsiderohen të ligjshme vetëm të ardhurat që janë deklaruar për të cilat janë paguar tatimet dhe taksat.
5. Nëse personi i vlerësuar ka pasuri dy herë më shumë se shumta e lejuar nëpërmjet të ardhurave të ligjshme, vlen prezumimi për marrjen e masës disiplinore me largim nga detyra dhe personi i vlerësuar ka barrën e provës. Për çdo gjykim penal që rrjedh nga një procedurë e tillë, barra e provës i takon shtetit.
6. Nëse personi i vlerësuar nuk e paraqet deklaratën e pasurive në kohë ose, ndërmerr hapa për ta deklaruar në mënyrë të pasaktë ose, fsheh pasuri në zotërim a përdorim të tij /të saj, vlen prezumimi për marrjen e masës disiplinore me largim nga detyra dhe

personi i vlerësuar ka barrën e provës. Për çdo gjykim penal që rrjedh nga një procedurë e tillë, barra e provës i takon shtetit.

## **Neni 6 Vlerësimi Paraprak**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen një vlerësim paraprak të personave që i nënshtrohen rivlerësimit sipas Nenit 184, paragrafi 1, me qëllim identifikimin e personave të vlerësuar me kontakte periodike të papërshtatshme me anëtarët e kimit të organizuar.
2. Personat e vlerësuar do të paraqesin një pyetësor të hollësishëm me të dhëna paraprake dhe një deklaram në Komision, për periudhën nga 1 janari 2012 deri më 31 dhjetor 2015, sipas rregullimit ligjor.
3. Nëse personi i vlerësuar ka kontakte periodike dhe të papërshtatshme me anëtarë të kimit të organizuar, vlen prezumi për marrjen e masës disiplinore me largim nga detyra dhe personi i vlerësuar ka barrën e provës. Për procedimet penale që rrjedhin nga këto procedura barra e provës i mbetet shtetit.
4. Nëse personi i vlerësuar nuk e paraqet pyetësorin me të dhëna paraprake ose deklaramin brenda afatit ose, ndërmerr hapa për të deklaruar të pasaktë ose të fshehtë kontakte me anëtarë të kimit të organizuar, vlen prezumimi për marrjen e masës disiplinore me largim nga detyra dhe personi i vlerësuar ka barrën e provës. Për procedimet penale që rrjedhin nga këto procedura barra e provës i mbetet shtetit.

## **Neni 7 Vlerësimi i Performancës**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen një vlerësim të performancës për personat që i nënshtrohen rivlerësimit sipas Nenit 184, paragrafi 1, me qëllim identifikimin e personave që vlerësohen, të cilët nuk janë të kualifikuar për të përmbushur rolin e tyre dhe kanë mangësi që mund të korrigjohen me masa riaftësimi.
2. Vlerësimi i performancës bëhet me ndihmën e inspektorëve që shërbejnë në shërbimet përkatëse të inspektimit, gjatë kohës së vlerësimit. Vlerësimi i Performancës për gjyqtarët vlerëson kapacitetin gjyqësor, aftësitë organizative, vendimet me shkrim, urdhrat dhe dekretet, etikën dhe përkushtimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara me ligj. Vlerësimi i Performancës për prokurorët vlerëson kapacitetin si prokurorë, hetimin, aftësitë organizative, vendimet me shkrim, urdhrat dhe kërkesat, etikën, vendimet për të mos ndjekur penalisht, angazhimin për vlerat prokuroruese, cilësitë personale dhe angazhimin profesional. Vlerësimi i Performancës për këshilltarët ligjorë vlerëson hulumtimin ligjor, produktin e shkruar, aftësitë organizative, etikën, cilësitë personale dhe përkushtimin profesional.
3. Drejtori i Komisionit që mbikëqyr vlerësimet e performancës, vlerëson dokumentet dhe informacionin, përgatit një raport që ia paraqet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe mund të paraqesë rekomandim për masa disiplinore.
4. Nëse personi i vlerësuar ka treguar njohuri, aftësi, gjykim ose qëndrim të papërshtatshëm, ose ka një model të përhershëm pune në papajtueshmëri me detyrën,

identifikohet mangësia dhe vlen prezumimi për marrjen e masës disiplinore me pezullim nga detyra, me masa edukative për korrigjimin e mangësisë dhe personi i vlerësuar ka barrën e provës. Për procedimet penale që rrjedhin nga këto procedura, barra e provës i takon shtetit.

5. Nëse personi i vlerësuar ka treguar njohuri, aftësi, gjykim ose qëndrim të papërshtatshëm, ose ka një model të përhershëm pune në papajtushmëri me detyrën, por mangësia nuk mund të korrigjohet me masa edukative ose trajnim, vlen prezumimi për marrjen e masës disiplinore me pezullim nga detyra dhe personi i vlerësuar ka barrën e provës. Për procedimet penale që rrjedhin nga këto procedura, barra e provës i takon shtetit.
6. Nëse personi i vlerësuar nuk përmbush në masë të konsiderueshme kërkesat e vlerësimit ose, ka treguar njohuri, aftësi, gjykim qëndrim të dobët a ka zbatuar në mënyrë konstante një model pune që mund të kërcënojë ose kufizojë të drejtat e qytetarëve, personi i vlerësuar konsiderohet i papërshtatshëm dhe vlen prezumimi për marrjen e masës disiplinore me largim nga detyra dhe personi i vlerësuar ka barrën e provës për të provuar të kundërtën. Për procedimet penale që rrjedhin nga këto procedura, barra e provës i takon shtetit.

#### **Neni 8 Vlerësimi i Kualifikimit të Shkallës së Parë**

1. Për çdo person që vlerësohet, Kancelari i Komisionit përmbledh dosjet, raportet dhe rekomandimet e bëra nga vlerësimet e Pasurive, vlerësimet Paraprake dhe ato të Performancës. Komisioni cakton një anëtar të Komisionit të Shkallës së Parë për të qenë Relator, sipas kritereve transparente.
2. Relatori mund të kërkojë informacion shtesë ose, mund të përpilojë propozim për gjetjet, si dhe mund të propozojë masë disiplinore për Komisionin. Personit të vlerësuar i jepet një kopje e gjetjeve dhe masës disiplinore të propozuar dhe ka të drejtën që, brenda një afati kohor të përcaktuar me ligj, të bjerë dakord të kundërshtojë, apo të paraqesë prova shtesë.
3. Komisioni i Shkallës së Parë i ofron personit të vlerësuar një seancë dëgjimore. Kjo e fundit, mund të përfshijë provime me gojë apo me shkrim, bazuar në fushën e eksperiencës së personit të vlerësuar.

#### **Neni 9 Masat Disiplinore**

1. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit çmon se, një person i vlerësuar duhet t'i nënshtrohet një mase disiplinore, Komisioni i Shkallës së Parë ose Apelit, nxjerr një vendim të arsyetuar, që vendos si masë disiplinore pezullim nga detyra për një vit me masë edukative ose, largimin nga detyra.
2. Një vendim i arsyetuar për masën për pezullim nga detyra për një vit, shoqëruar me masë edukative, duhet të identifikojë mangësitë e personit të vlerësuar, pezullon zyrtarin me 60% të pagës së gjyqtarit të shkallës së parë dhe e detyron personin e vlerësuar të fillojë programin e edukimit në Shkollën e Magjistraturës, gjatë një viti të masës riaftësuese me qëllim korrigjimin e mangësive. Në përfundim të programit

edukues, zyrtari i pezulluar i nënshtrohet provimit. Provimi bëhet me mbikëqyrjen e Komisionit Evropian. Personat e vlerësuar që nuk kalojnë provimin largohen nga detyra nga Komisioni i Shkallës së Parë dhe kanë të drejtën të paraqesin ankim në Komisionin e Shkallës së Apelit. Vendimi i këtij Komision është përfundimtar.

3. Një vendim i arsyetuar që urdhëron largimin nga detyra ka efekt të menjëhershëm, përveç rasteve kur paraqitet ankim. Në rast ankimi, paga punonjësi paguhet me 60% të pagës së një gjyqtari të shkallës së parë. Në rast të një ankimimi të suksesshëm, paguhet pjesa e mbetur prej 40%. Në rast se largimi nga detyra hyn në fuqi, shuma prej 60% e pagës që i është paguar i rimbursohet shtetit nga personi i vlerësuar. Një vendim përfundimtar që urdhëron largimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm *ex lege*.
4. Një person i vlerësuar, i cili bën ankim ndaj një mase disiplinore pezullohet nga detyra, në pritje të vendimit të Komisionit të Shkallës së Apelit.
5. Një person i vlerësuar mund të bjerë dakord me Komisionin për të dalë në pension më herët dhe për ta marrë pensionin menjëherë. Shuma e pensionit reduktohet duke marrë parasysh vitet e punës të kryera nga personi, dhe vitet e mbetura deri në moshën e pensionit.

#### **Neni 10 Vlerësimi i Kualifikimit në Shkallën e Apelit**

1. Personi i vlerësuar dhe secili prej Komisionerëve Publik kanë të drejtën të paraqesin ankim në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të shkallës së dytë, brenda afateve kohore të parashikuara në ligj.
2. Vëzhguesi ndërkombëtar merr pjesë me të njëjtat të drejta si në shkallë të parë. Nëse Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron të drejtën për të transferuar vendimin në Komisionin e Pavarur të Zgjeruar, në rastin kur ekziston Komisioni i Shkallës së Parë, atëherë Komisioni i Zgjeruar do të përbëhet nga anëtarët fillestarë të Komisionit të Apelit dhe tre anëtarë zëvendësues, të cilët nuk kanë marrë vendim në shkallë të parë. Në rast se ekzistojnë dy apo tre Komisione të Shkallës së Parë, Komisioni i Zgjeruar do të përbëhet nga anëtarët fillestarë të Komisionit të Apelit dhe të një Komisioni tjetër, ose nëse këta nuk mund të marrin pjesë, atëherë do të përbëhet tre nga anëtarët zëvendësues të cilët nuk kanë marrë vendime në Shkallë të Parë.
3. Komisioni i Shkallës së Apelit lë në fuqi ose ndryshon vendimin e Komisionit të Shkallës së Parë në një vendim të arsyetuar me shkrim. Ai mund të mos vendosë një masë më të rreptë disiplinore, pa i ofruar personit të vlerësuar njoftim të mjaftueshëm për t'u përgatitur dhe për t'u përgjigjur në një seancë.
4. Nëse një person i vlerësuar jep dorëheqjen, del në pension ose pajtohet me një raport dhe rekomandim, nuk mund të ketë apelim.
5. Komisioni i Shkallës së Apelit është shkalla e fundit e shqyrtimit. Nuk ka instanca të mëtejshme vlerësimi brenda juridiksionit shqiptar.